



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT DURRES

UDHËZIMI PËRGJITHSHËM

Nr. 1 datë 22.072021

“MBI MASAT PROCEDURIALE DHE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2021” SI DHE NDRYSHIMEVE TË REJA PENALE DHE PROCEDURIALE PENALE”

Bazuar në ligjin Nr 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.04 datë 09.07.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, Urdhërat e Prokurorit të Përgjithshëm nr.78 datë 09.07.2021 dhe nr.79 datë 09.07.2021, Rregulloren e Prokurorisë së Apelit Durrës,

Pas takimit të zhvilluar me prokurorët sipas nenit 5 pika 1 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.04 datë 09.07.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, në vlerësim mendimeve të marra nga prokurorët, të nevojave për marrjen e masave administrative dhe proceduriale, në bazë të kompetencave që ngarkon ligji Nr 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si edhe në zbatim të nenit 10, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 04 datë 09.07.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e këtij udhëzimi të përgjithshëm me qëllim lehtësimin e zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 04 datë 09.07.2021 të Prokurorit të Përgjithshëm brenda fushës së përgjegjësisë të Prokurorisë së Apelit Durrës.
2. Prokurorët të marrin masa për zbatimin e akteve të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm respektivisht:
 - Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 04 datë 09.07.2021 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.
 - Urdhëri nr.78 datë 09.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurrores për vitin 2020”.
 - Urdhëri nr. 79 datë 09.07.2021 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”.
3. Në zbatim të nenit 6 pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 04 datë 09.07.2021, Drejtuesi monitoron ecurinë dhe

përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht të afateve procedurale dhe efektivitetit të ndjekjes së akuzës. Në funksion të këtij monitorimi, kërkohet në vijim:

- Të tregohet kujdes dhe vëmendje nga prokurorët për zbatimin sipas fushës së përgjegjësisë, të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas prioriteteve të rekomanduara dhe planeve të veprimit të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm.
- Të jenë aktivë në ecurinë dhe përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke respektuar në veçanti afatet procedurale, rritjen e efektivitetit të akuzës.
- Të tregohet kujdes dhe vëmendje nga prokurorët për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës për të kërkuar sipas rastit aplikimin e dënimeve alternative kryesisht në veprat penale dhe autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht tek të miturit, personat vulnerabël dhe ata me probleme shëndetësore.
- Në raport me theksin që vihet tek Rezoluta dhe Rekomandimet për veprat penale dhe autorët me rrezikshmëri të lartë shoqërore, prokurorët të mbajnë në vëmendje ashpërsimin e masave të sigurimit dhe dënimeve.
- Në aspektin e respektimit të lirive të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekja penale, të mbahet në vëmendje garantimi i respektimit të të drejtave që u njeh ligji procedural penal në aspektin e njohjes me akuzat, materialet e çështjes dhe të komunikimit procedural me palët.
- Në kuadrin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personit, prokurorët duhet të mbajnë në vëmendje afatet e shuarjes së masave të sigurimit për shkak të mbarimit të dënimit si dhe afatet e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.
- Prokurori të bëjë analizën e ngarkesës individuale të çështjeve që do të shërbejë edhe si tregues i ngarkesës së Prokurorisë së Apelit Durrës në tërësi, për vlerësim nëse është ngarkesë e përballueshme në masën që nuk cënon cilësinë e përfaqësimit të akuzës në Gjykatën e Apelit. Ky monitorim duhet të jetë i vazhdueshëm për përgatitjen e një udhëzimi të përgjithshëm “Për përcaktimin e normës, volumit orientues të punës në prokurori”, siç përcaktohet edhe në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë.
- Prokurorët të jenë aktivë në mbledhjet tematike që zhvillohen periodikisht nga Drejtuesi, duke prezantuar në këto takime problematikat e evidentuara gjatë veprimtarisë së përditshme, veçanërisht ato që lidhen me rekomandimet prioritare. Evidentimi i problematikave do të bëhet me qëllim grupimin e tyre dhe informimin e Prokurorit të Përgjithshëm në raportimin periodik që kërkohet sipas Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 79/2021.
- Prokurorët të jenë aktivë në trajnimet që zhvillohen nga Shkolla e Magjistraturës, por dhe në trajnimet që mund të zhvillohen edhe brenda vetë sistemit të Prokurorisë. Drejtuesi do të marrë masat e nevojshme për ngarkesën e punës në mënyrë që të respektohen datat e zhvillimit të seminareve dhe trajnimeve.

4. Në kuadër të ndryshimeve të fundit të K.Pr.Penale dhe K.Penal, kërkohet nga prokurorët dhe administrata:

A. Për çështjet penale që do të zhvillohen në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 427/a të K.Pr.Penale shtuar me ligjin nr.41/2021:

- Dosjet të sillen në Prokurori më herët se 5 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës gjyqësore, me qëllim që prokurorët të kenë kohën e mjaftueshme për dërgimin e parashtrimeve brenda afati ligjor 5 ditë para seancës. Ngarkohet Kryesekretaria të komunikojë me Gjykatën e Apelit për tërheqjen në kohë të dosjeve.
- Lidhur me dërgimin e parashtrimeve, nëse prokurorët vlerësojnë të procedojnë me dërgim të parashtrimeve me shkrim, krahas afateve të përcaktuara në nenin 427/a të K.Pr.Penale shtuar me ligjin nr.41/2021, të mbajnë në vëmendje që dërgimi i tyre të kryhet me shkresë përcjellëse. Në vlerësimin për dërgimin me shkrim të parashtrimeve, prokurorët të mbajnë në vëmendje veçanërisht çështjet që i përkasin veprave penale sipas rekomandimeve prioritare. Ndërsa për çështjet për të cilat prokurorët vlerësojnë se nuk është rasti për dërgim parashtrimesh me shkrim, të shënojnë në kartelën përmblyllëse të dosjes së gjykimit arsyen e mosdërgimit të parashtrimeve.

B. Lidhur me ndryshimet e dispozitave të K.Pr.Penale sa i përket ushtrimit të rekursit:

- Për shkak të lidhjes së afatit të ushtrimit të rekursit me njoftimin e vendimit nga Gjykata e Apelit, ngarkohet Kryesekretaria që vendimet të pranojë nga Gjykata e Apelit të shoqëruara vetëm me dëftesë komunikimi. Në lidhje me këtë, prokurorët duhet të depozitojnë listën emërore të rasteve të ushtrimit të rekursit në Kryesekretari dhe kjo e fundit, menjëherë pas marrjes nga Gjykata e Apelit të vendimeve të kërkuara, ua dorëzon ato prokurorëve përkatës, në respektim të procedurës së qarkullimit të akteve nëpërmjet Librit të Protokollit të Komunikimeve të Brendshme.
- Për unifikimin e formatit të rekurseve, në zbatim të nenit 434/a të K.Pr.Penale të ndryshuar, prokurorët mund të referohen në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, nga ku mund të shkarkojnë formatin e miratuar nga kjo gjykatë.
- Për rastet kur nuk do të ushtrohet rekurs, prokurori duhet të vendosë në rubrikën përkatëse të kartelës përmblyllëse të dosjes, shënimin mbi shkaqet e mosushtrimit të rekursit. Kjo në zbatim edhe të Udhëzimit e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës si dhe udhëzimit nr.1 datë 07.09.2020 të Prokurorisë së Apelit Durrës.
- Rekurset e paraqitura nga palët duhet tu komunikohen prokurorëve të cilët në zbatim të nenit 435/a të K.Pr. Penale të ndryshuar me ligjin nr.41/2021, bëjnë vlerësimin nëse do të ushtrojnë ose jo kundër-rekurs. Për shkak të lidhjes së afatit të ushtrimit të kundër-rekursit me ditën e marrjes njoftim për rekursin e palës tjetër, ngarkohet Kryesekretaria që menjëherë pas administrimit, rekurset e ushtruara nga palët tu vihen në dispozicion prokurorëve përkatës në respektim të procedurës së

qarkullimit të akteve nëpërmjet Librit të Protokollit të Komunikimeve të Brendshme.

5. Në funksion të monitorimit të çështjeve në gjykim, Kryesekretaria duhet të përditësojë regjistrin e çështjeve penale me datën e përfundimit të gjyqimit dhe ta vërë këtë regjistër në dispozicion të Drejtuesit sa herë ti kërkohet.
6. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të administratës.
7. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I PROKURORISË SË APELIT

Ludovik DODAJ

